



SHËRBIMI SOCIAL

# BULETINI MUJOR

Mars  
2026



Gjatë muajit mars, muajit të punës sociale, Shërbimi Social Shtetëror ndërmori një nismë të veçantë me qëllim afrimin e të rinjve me realitetin e profesionit të punonjësit social.

Në kuadër të iniciativës “Punonjës social për 1 ditë”, studentëve iu dha mundësia të angazhoheshin drejtpërdrejt pranë profesionistëve në terren dhe në institucione të ndryshme të përkujdesit shoqëror. Kjo eksperiencë u mundësoi atyre të njihen nga afër me sfidat, përgjegjësitë dhe ndikimin e drejtpërdrejtë që ka puna sociale në jetën e individëve dhe komuniteteve. Gjatë kësaj nisme, studentët u përfshinë në proceset e komisioneve biopsikosociale për vlerësimin e aftësisë së kufizuar, në procedurat e vlerësimit të ndihmës ekonomike, si dhe në aktivitetet e institucioneve të përkujdesit për fëmijë. Shërbimi Social Shtetëror rithekson angazhimin për të vijuar me iniciativa të ngjashme në të ardhmen, duke besuar se zhvillimi dhe forcimi i shërbimeve sociale ndërtohet në bashkëpunim të ngushtë me brezat e rinj.



Edhe pse për shumë gra kjo e dielë e 8 Marsit është një ditë pushimi dhe festimi, për gratë dhe vajzat që punojnë në Shërbimin Social Shtetëror ajo ka qenë një ditë e zakonshme pune, e mbushur me përkushtim dhe përgjegjësi ndaj më të pambrojturve.

Në qendrat sociale dhe institucionet e kujdesit, ato kanë vijuar pa ndërprerje misionin e tyre, duke qëndruar pranë fëmijëve dhe të moshuarve që kanë nevojë për mbështetje, kujdes dhe dashuri. Me ndjeshmëri të lartë dhe një forcë të heshtur që buron nga zemra, këto gra janë çdo ditë një shtyllë e rëndësishme për komunitetin.

Një trëndafil simbolik është dedikuar për secilën prej tyre, si shenjë respekti dhe falënderimi për kontributin e vazhdueshëm në përmirësimin e jetës së të tjerëve.



**SHËRBIMI SOCIAL**

Shërbimi Social Shtetëror

📍 Rruga e Durrësit, nr. 83, Tiranë, Shqipëri

☎ 044 54 18 21

✉ [info@sherbimisocial.gov.al](mailto:info@sherbimisocial.gov.al)

🌐 [www.sherbimisocial.gov.al](http://www.sherbimisocial.gov.al)